



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/113

Datë: 08.03.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 mars 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet; 110, 111 dhe 112 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THACI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/113

Datë: 08.03.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 mars 2010, mori

V E N D I M

Për themelimin e grupeve punuese për zbatimin e Strategjisë gjithëpërfshirëse për veriun e Kosovës

1. Për zbatimin e Strategjisë gjithëpërfshirëse për veriun e Kosovës themelohen këto grupe punuese:
 - 1.1. Grupi punues për sundim të ligjit;
 - 1.2. Grupi punues për kthim, pajtim dhe inicim të dialogut ndëretnik;
 - 1.3. Grupi punues për zhvillim socio-ekonomik të rajonit;
 - 1.4. Grupi punues për zhvillimin e reformës së pushtetit lokal;
 - 1.5. Grupi punues për ngritjen e shërbimeve publike;
 - 1.6. Grupi punues për komunikim.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Koordinatorin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për zbatimin e Strategjisë gjithëpërfshirëse për veriun e Kosovës, i emëruar me vendimin Nr. 02/112 të datës 3 mars 2010, të Qeverisë së Kosovës, dhe të gjitha institucionet tjera përgjegjëse.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/113

Datë: 08.03.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 mars 2010, mori

V E N D I M

1. Të rritet buxheti dhe numri i stafit në Agjencinë për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar apo Konfiskuar për 17 pozita.
2. Punësimi i stafit nga pika 1 e këtij vendimi kryhet në pajtim me ligjin.
3. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin t'ia procedojë Kuvendit të Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë


Hashim THACI
Kryeministër i Kosovës



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/113

Datë: 08.03.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 mars 2010, mori

V E N D I M

1. Të iniciohet procedura për hartimin e Strategjisë Nacionale dhe Planit të Veprimit për Siguri në Bashkësi.
2. Bartës i këtij procesi caktohet Ministria e Punëve të brendshme.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THACI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/113
Datë: 08.03.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 mars 2010, mori

V E N D I M

Për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit Nr. 04/35, të datës 10.09.2008, për pagesën e trajnerëve të angazhuar në Institutin e Kosovës për Administratë Publike

1. Pas pikës 5 të vendimit Nr. 04/35, të datës 10.09.2008 shtohet një pikë e re, si pika 5a. me këtë përmbajtje: "Trajnerët e angazhuar, që kanë statusin e nëpunësit civil kanë të drejtë të marrin kompensim, i cili bëhet nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime".
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THACI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/113

Datë: 08.03.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 mars 2010, mori

V E N D I M

1. Të bëhet alokimi i parakohshëm i mjeteve nga komunat për periudhën janar-korrik 2010 për shtesat mujore të shërbimit të zjarrfikësve në vlerë prej 107 euro në emër të rrezikshmërisë në punë, të aprovuar me Ligjin për Buxhetin Nr. 03/-177 për vitin 2010 në buxhetin e Ministrisë së Punëve të Brendshme.
2. Numri i pjesëtarëve nga pika 1 e këtij vendimi është 718 (shtatëqind e tetëmbëdhjetë) dhe i cili përfshinë të gjitha komunat e Kosovës.
3. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme që në procesin e rishikimit, të kryej transferin e shumës totale sipas komunave në tabelat e buxhetit të komunave, në pajtim me ligjin e buxhetit për vitin 2010.
4. Të drejtat nga pika 1 dhe 2 e këtij vendimi realizohen retroaktivisht nga 1 janar 2010.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria për Ekonomi dhe Financa dhe Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/113


Datë: 08.03.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 mars 2010, mori

V E N D I M

1. Punëtorëve shëndetësorë që punojnë në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë (Departamenti për mjekësi ligjore dhe persona të zhdukur dhe stafit të shëndetësisë në SHKK) iu rritet paga bazë 30 për qind njësoj si në sektorin e shëndetësisë.
2. Stafit të uniformuar të Shërbimit Korrektues të Kosovës i aprovet rritja e pagës bazë për një koeficient më të lartë për 1.390 zyrtarë.
3. Stafit tjetër jo të uniformuar të Shërbimit Korrektues të Kosovës, 183 pozita, i miratohet shtesa për rrezikshmëri në punë në vlerë mujore prej 35.00 euro.
4. Pika 1, 2 dhe 3 e këtij vendimi zbatohet në mënyrë retroaktive nga 1 janari 2010.
5. Ministria e Drejtësisë pagesat do t'i sigurojë nga buxheti i saj i ndarë për vitin 2010, deri në procesin e rishikimit të buxhetit.
6. Me procesin e rishikimit të buxhetit për vitin fiskal 2010, obligohen t'i ndajnë nga 57.531 (pesëdhjeteshtatë mijesëqindetridhjetenjë) euro nga buxheti i tyre, nga kategoria mallra dhe shërbime, për të mbuluar këto shpenzime shtesë:
 - 6.1. Zyra e Kryeministrit;
 - 6.2. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
 - 6.3. Ministria e Administratës Publike;
 - 6.4. Ministria e Shëndetësisë;
 - 6.5. Ministria e Ekonomisë dhe Financave;
 - 6.6. Ministria e Energjisë dhe Minierave;
 - 6.7. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;

- 6.8. Ministria e Pushtetit Lokal;
 - 6.9. Ministria e Punëve të Brendshme;
 - 6.10. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
 - 6.11. Ministria për Komunitete dhe Kthim;
 - 6.12. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
 - 6.13. Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit;
 - 6.14. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
 - 6.15. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.
7. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria e Drejtësisë, dhe të gjitha ministrinë e cekura në pikën 5 të këtij vendimi.
8. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THACI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/113

Datë: 08.03.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 mars 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet Projektligji për Energjinë Elektrike.
2. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

 Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/113

Datë: 08.03.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 mars 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet, me vërejtje, Udhëzimi Administrativ për procedurat e delegimit të përgjegjësive për skemën e ndihmave sociale në nivel komunal.
2. Ngarkohet Zyra për Shërbimet e Ndhmës Juridike për Inkorporimin e vërejtjeve.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THACI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë